



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 61006-00757-2020 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2020-457 i Vendimit**

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Illir PANDA</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Sokol SADUSHI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ervin PUPE</b>	<b>Anëtar</b>

Sot në datë 18.12.2020 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

- KËRKUES:** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- KUNDËR:** Personit nën hetim Artan Shkëmbi
- I DYSHUAR:** Për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike“ dhe “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, të parashikuara nga nenet 259 dhe 295/a të Kodit Penal.
- OBJEKTI:** Caktimin ndaj të hetuarit Artan Shkëmbi, të masës së sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 228, 229, 240, 242, 244/1 të Kodit të Procedurës Penale.

**KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Ilir Panda dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. Rrethanat e çështjes**

1. Nga aktet e përfshira në fashikullin e gjykimit të kësaj kërkese penale rezulton se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim prokuroria e

posaçme) ka regjistruar procedimin penal nr. 227, datë 11.09.2020, “Organizimi dhe drejtimi i organizatave kriminale”, në formën e krijimit të kushteve dhe lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, parashikuar nga neni 284/a pika ‘2 e Kodit Penal. Ndërkohë, gjatë gjyqimit të kësaj çështje në apel, rezultoi se në datë 25.09.2020 prokuroria e posaçme ka disponuar me urdhër për regjistrimin e emrit të personit nën hetim Artan Shkëmbi, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatës të procedimit penal nr. 227, të vitit 2020, si i dyshuar për veprat penale: “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, parashikuar nga neni 295/a i Kodit Penal dhe “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

2. Ky procedim penal është regjistruar pas referimit nga Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë, të informacionit të marrë nga Zyra e Oficerit Ndërlidhës të kësaj ambasade në Shqipëri. Sipas këtij informacioni që mban datën 09.09.2020, rezultoi se në Gjermani po hetohen dy shtetas shqiptarë të dyshuar për import të paligjshëm kokaine (trafikim i narkotikëve sipas ligjit shqiptar). Në kuadër të hetimit që po zhvillohet në Gjermani është konstatuar se të dyshuarit janë informuar për hetimet në ngarkim të tyre, informacion që dyshohet të jetë përcjellë nëpërmjet një punonjësi të Policisë së Shtetit dhe një personi të afërt të tij. Sipas këtij informacioni ekziston dyshimi që punonjësi i policisë së shtetit ju ka dhënë rregullisht informacione, në mënyrë indirekte, nëpërmjet personit të kontaktit apo edhe direkt anëtarëve të grupeve kriminale. Në këto rrethana, në kuadër të bashkëpunimit oficeri ndërlidhës ka kërkuar nga autoritetet shqiptare, identifikimin e punonjësi dhe nisjen e një hetimi për të verifikuar nëse është konsumuar vepër penale në mbështetje të një organizate kriminale apo grupi të strukturuar kriminal.

3. Nga aktet e përfshira në fashikullin bashkëngjitur kërkesës për caktim mase ndaluese, rezultoi se Prokuroria e Hamburgut në Gjermani po kryen hetime në ngarkim të shtetasve shqiptarë K.V. dhe A.P., si dhe ndaj personave të tjerë të dyshuar për trafik të paligjshëm të kokainës, duke importuar në Gjermani sasi të konsiderueshme. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, evidentohet se nëpërmjet Ambasadës Gjermane, Grupi i përbashkët hetimor ka përcjellë në datë 19.03.2020 kërkesën për verifikimin e pasurive të zotëruara nga shtetasit K.V. dhe A.P., në Shqipëri, si dhe verifikimin e të dhënave të tjera të vlefshme për hetimin pasuror apo hetimin penal. Kjo kërkesë është shoqëruar me kërkimin që verifikimet të kryhen... *“nëse mund të garantohet që këto informacione nuk do të arrijnë te personat nën hetim në Gjermani, nëse jo, ju lutemi që kërkesa të mos përpunohet deri sa hetimet në Gjermani të kalojnë në fazën e hapur”*. Sipas akteve të fashikullit, kjo kërkesë është depozituar në Policinë e Shtetit në datë 03.04.2020, ndërkohë që përgjigje zyrtare është kthyer në datë 22.04.2020. Zyra e Oficerit Ndërlidhës, në informacionin e përcjellë pranë prokurorisë së posaçme thekson se, nuk ka të dhëna që përgjigja e kërkuar të jetë dërguar para datës 22.04.2020. Ndërkohë, gjatë hetimeve të zhvilluara në Gjermani, ka rezultuar se kjo kërkesë e autoriteteve gjermane për verifikimin e pasurive apo verifikime të tjera të dobishme për hetimet e nisura ndaj shtetasve K.V dhe A.P., i është dërguar të hetuarit K.V. në datë 10.04.2020 rreth orës 16:00. Përveç kërkesës së datës 19.03.2020 të Grupit të Përbashkët Hetimor për Narkotikët në Kil (GER Kiel) është evidentuar nga autoritetet gjermane se shtetasit K.V. i janë përcjellë edhe fotot e tij dhe të personit tjetër nën hetim A.P., së bashku me të dhënat e nxjerra nga sistemi Deep See.

4. **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, me vendimin nr. 98, datë 27.09.2020, ka vendosur:

*Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.*

*Caktimin e masës së sigurimit personal të karakterit ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit Artan Shkëmbi, i biri i Pajo dhe Veziko, lindur në datë 11.10.1967, në Fier, me shtetësi e kombësi*

shqiptare, me arsim të lartë, me detyrë Zëvendësdrejtor i OFL dhe Drejtor i Hetimit në Strukturat e Posaçme Operacionale Forca e Ligjit, i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, të parashikuar nga nenet 259 dhe 295/a të Kodit Penal.

Pezullimin nga detyra “Zëvendësdrejtor i OFL dhe Drejtor i Hetimit në Strukturat e Posaçme Operacionale Forca e Ligjit “ të personit nën hetim Artan Shkëmbi duke u ndaluar të kryejë këtë detyrë si dhe veprimtarinë që lidhet me të.

Urdhërohet policia gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda afatit ligjor”.

**5. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,** me vendimin nr. 99, datë 01.10.2020, ka vendosur:

Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal të karakterit ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit Artan Shkëmbi, me detyrë Zëvendësdrejtor i OFL dhe Drejtor i Hetimit në Strukturat e Posaçme Operacionale Forca e Ligjit, i dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Korrupsionit pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, të parashikuar nga nenet 259 dhe 295/a të Kodit Penal.

Pezullimin nga detyra “Zëvendësdrejtor i OFL dhe Drejtor i Hetimit në Strukturat e Posaçme Operacionale Forca e Ligjit “ të personit nën hetim Artan Shkëmbi duke u ndaluar të kryejë këtë detyrë si dhe veprimtarinë që lidhet me të.

Urdhërohet policia gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda afatit ligjor”.

**6. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar,** me vendimin nr. 31, datë 15.10.2020, ka vendosur:

Miratimin e vendimit nr. 99, datë 19.02.2019 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 242 i Kodit të Procedurës Penale ndaj shtetasit Artan Shkëmbi, marrë me vendimin nr. 98, datë 27.09.2020 të asaj gjykate”.

Duke arsyetuar ndër të tjera se ka dyshime të bazuara në prova, në kuptim të nenit 149 të K. Pr. Penale se i hetuari Artan Shkëmbi, mund të ketë përcjellë të dhëna që janë të mbuluara nga sekretit hetimor tek personat që po hetohen në Gjermani, përmes një personi të tretë akoma të paidentifikuar. Në vlerësimin total të këtij kolegji, të dhënat e përfituara nga këqyrja e sistemit Deep See janë në përputhje dhe konform edhe me deklaratimet e oficerëve të policisë gjyqësore të shtetit, deklaratimet e të cilëve japin njoftime mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale dhe janë burim prove në kuptim të ligjit procedural penal. Në lidhje me llojin dhe masën e sigurimit, gjykata e posaçme e apelit, vlerëson se në rastin konkret, ekzistojnë kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 229 të K. Pr. Penale për caktimin e masës së sigurimit personal të karakterit ndalues. Në vlerësimin e gjykatës së posaçme të apelit, veprat penale për të cilat dyshohet i hetuari, si ajo e parashikuar nga paragrafi i tretë i nenit 295/a të Kodit Penal, ashtu edhe vepra penale e parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, janë krime që paraqesin rrezikshmëri, pasi cenojnë veprimtarinë e rregullt të institucioneve shtetërore, duke sjellë pasoja në luftën kundër kriminalitetit të organizuar apo në bashkëpunimin me autoritetet e huaja të hetimit apo të gjykimit. Shtetasi Artan Shkëmbi për shkak të funksionit të tij si drejtues i lartë në Policinë e Shtetit,

dyshohet se ka zbuluar akte sekrete, duke dekonspiruar hetimet që po zhvilloheshin në Gjermani ndaj disa shtetasve shqiptarë, veprim ky që dyshohet të jetë kryer prej tij për shkak të marrjes së një përfitimi të parregullt apo duke ndihmuar këto shtetas të dyshuar si pjesë e një organizate kriminale, duke krijuar lehtësi për to në vijimin e aktiviteti kriminal. Caktimi i masës ndaluese “pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, në vlerësim të këtij kolegji është i drejtë deri në këtë fazë të procedimit penal, në raport me shkallën e nevojave të sigurimit e lidhur kjo me rrezikshmërinë që paraqet personi nën hetim Artan Shkëmbi dhe me faktin penal për të cilin ai dyshohet. Ky kolegji i gjykatës së posaçme të apelit, vlerëson se kjo masë ndaluese privon të hetuarin që të ndërhyjë në procesin e të provuarit, për të shmangur ndikimin mbi provat, si dhe për të shmangur çdo mundësi kontakti me dëshmitarët e mundshëm në kuadër të këtij procedimi penal.....I hetuari dhe avokati theksuan se vendimi i gjykatës së posaçme të shkallës së parë është i pavlefshëm, pasi mungon arsyetimi i kushteve dhe i kriterëve për caktimin e masave të sigurimit, në kuptim të nenit 245, pika 1 shkronjat ‘c’ dhe ‘ç’ të K. Pr. Penale. Në verifikim të këtij shkak, kolegji konstaton se gjykata e posaçme e shkallës së parë ka parashtruar në vendimin e saj, shkaqet dhe të dhënat që përlligjin kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës ndaluese ‘pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik’. Ajo gjykatë ka parashtruar rrethanat e faktit dhe provat e verifikuara deri në këtë fazë të procedimit penal nga prokuroria e posaçme, ka evidentuar faktin se i vetmi person që ka loguar në sistemin Deep See në datë 10.04.2020 është pikërisht i hetuari Shkëmbi, duke argumentuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, kusht i përcaktuar në nenin 228 pika 1; ka evidentuar rrezikshmërinë e veprave penale dhe personalitetin e të hetuarit, duke vlerësuar kriteret e përcaktuara në nenin 229 të K. Pr. Penale, në raport me nevojat e sigurimit, si dhe ka referuar ekzistencën e kushtit të posaçëm të parashikuara në shkronjën ‘a’ të pikës 3 të nenit 228 të K. Pr. Penale (vënia në rrezik e marrjes apo vërtetësisë së provës). Në këto rrethana, ky kolegji çmon se gjykata e posaçme e shkallës së parë ka argumentuar mjaftueshëm jo vetëm elementin e kërkuar nga shkronja ‘c’ e pikës ‘1’ të nenit 245 të K. Pr. Penale, por edhe elementet e tjerë të parashikuara në këtë dispozitë. Ky vlerësim i gjykatës së posaçme të apelit bazohet në argumentimin e bërë nga gjykata e posaçme e shkallës së parë, si në vendimin e caktimit të masës ndaluese, ashtu edhe në vendimin e verifikimit të kushteve dhe të kriterëve të zbatimit të kësaj mase sigurimi ndaluese. Në lidhje me mungesën e argumentimit të shkaqeve të parashtruara në shkronjën ‘ç’ të kësaj dispozite, ky kolegji evidenton se kjo dispozitë kërkon një argumentim më të thelluar në rastet kur ndaj të hetuarve caktohet një masë sigurimi shtrënguese, nga ato që kufizojnë lirinë e të hetuarit, e konkretisht masat e sigurimit të parashikuara nga nenet 237, 238 dhe 239 të K. Pr. Penale (duke argumentuar shkaqet pse masat e tjera janë të papërshtatshme). Në rastin konkret, ndaj të hetuarit Shkëmbi, është caktuar një masë ndaluese, për të cilat ligji procedural penal parashikon vetëm një kusht të posaçëm për zbatimin e tyre - ‘kur i hetuari procedohet për vepra penale për të cilat ligji cakton dënim me burgim më të lartë në maksimum se një vit. Në rastin konkret, i hetuari Artan Shkëmbi dyshohet për veprën penale të parashikuara nga neni 295/a, paragrafi i tretë i të cilit parashikon një dënim me burgim nga një deri në pesë vjet; si dhe për veprën penale të parashikuara nga neni 259 i K.Penal, vepër penale që ka sanksion dënimi me burgim, nga dy deri në tetë vjet.

6. Kundër vendimit me nr. 31, datë 15.10.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs me datë 18.11.2020, personi nën hetim Artan Shkëmbi, i nënshkruar dhe nga mbrojtësi Artan Broci me të cilin ka kërkuar: *Prishjen e vendimit me nr. 31, datë 15.10.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, heqjen e masës së sigurimit personal me karakter ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” dhe pushimin e shqyrtimit të çështjes pa e kthyer për rishqyrtim, duke pretenduar këto shkaqe:*

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në vendimin objekt rekursi ka gabuar në zbatimin e ligjit penal dhe atij procedural, pasi ka marrë rolin e gjyqtarit të seancës paraprake, duke caktuar akuzën sipas kësaj gjykate e konkretisht nenin 295/a, paragrafi i tretë i Kodit Penal.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite në Kodin Penal, ajo mund të konsiderohet si një dispozitë blanket, pasi referon në kritere që ligji i posaçëm i klasifikon të dhënat e dyshuara si të nxjerra sekret. Nga aktet e deritanishme nuk rezulton që të jetë individualizuar nga organi i akuzës se cili është ligji i posaçëm që i klasifikon të dhënat e transmetuara si të dhëna sekret.

Organi i akuzës ka detyrimin ligjor të përcaktojë se cilën dispozitë të ligjit material ka shkelur personi nën hetim Artan Shkëmbi në nxjerrjen e këtij informacioni pasuror. Informacioni i pretenduar (supozuar) si i nxjerrë prej personit nën hetim Artan Shkëmbi është një informacion pasuror dhe kurrësi nuk mund të klasifikohet si një informacion me karakteristikat e një sekreti shtetëror; tregtar apo hetimor.

Referuar vendimit unifikues nr. 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në të cilin është përcaktuar roli i Gjykatës në caktimin e masës së sigurimit, gjykata nuk mund të përcaktojë dhe akuzën apo elemente të saj si në çështjen objekt rekursi. Gjykata në pjesën arsyetuese të vendimit ka arsyetuar se, *ky kolegji vlerëson se ekzistojnë elementët e veprës penale "Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete"*, parashikuar nga neni 295/a, 3 të K. Penal.

Gjykata e Posaçme e Apelit, referon në mënyrë të gabuar si shkelje të neneve 103 dhe 279 të K. Pr. Penale të kryera nga personi nën hetim Artan Shkëmbi, kur nga aktet e administruara në këtë fazë të procedimit nuk rezulton që Prokuroria e Posaçme të ketë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të shtetasve A.P dhe K.V. dhe aq më shumë të ketë paralajmëruar më parë personin nën hetim Artan Shkëmbi për përgjegjësinë penale sipas dispozitave të mësipërme. Analizimi me kujdes i dispozitave të pretenduara si të shkelura (*jashtë influencës mediatike*) bazuar në nenin 3 të K. Pr. Penale do ta çonte gjykatën në konkluzionin e drejtë se jemi përpara rastit të padënueshmërisë, kusht i përcaktuar në nenin 228 të Kodit të Procedurës Penale.

Në të tilla rrethana mendoj se ka vend që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të njehsojë praktikën gjyqësore, për rolin e gjykatës dhe rolin e gjyqtarit të seancës paraprake në caktimin e masës së sigurimit dhe se a mundet që gjykata që shqyrton kërkesën e caktimit/vlerësimit të masës së sigurimit të përcaktojë akuzë siç ka ndodhur në çështjen objekt rekursi apo kjo detyrë i takon ekskluzivisht vetëm gjyqtarit të seancës paraprake.

Gjykata e Posaçme ka shkelur parimin *in dublo pro reo*, kur ka arsyetuar se...*në ndryshim nga sa argumentoi mbrojtësi, vlerëson se ka dyshime të bazuara në prova, në kuptim të nenit 149 të K. Pr. Penale se, i hetuari Artan Shkëmbi mund të ketë përcjellë të dhëna që janë të mbuluara nga sekreti hetimor tek personat që po hetohen në Gjermani, përmes një personi të tretë të pidentifikuar.* Pretendimi i parashtruar nga mbrojtja është se i hetuari nuk ka asnjë marrëdhënie me shtetasit që po hetohen në Gjermani, qofshin këto shoqërore, familjare apo krahinore-elementë ky që përforcon dyshimin se dhënia e informacionit është kryer për qëllime apo përfitime të paligjshme.

Gjykata e Posaçme ka shkelur "Parimin e prezumimit të pafajësisë" të parashikuar nga neni 4 i K. Pr. Penale, pasi nga njëra anë arsyeton se, *kemi një person të tretë të pidentifikuar akoma dhe nga ana tjetër arsyeton se, mospasja e asnjë lloj lidhje apo marrëdhënie me shtetasit që po hetohen në Gjermani, qofshin këto lidhje shoqërore, familjare apo krahinore, përforcon dyshimin se dhënia e informacionit është kryer për qëllime apo përfitime të paligjshme.* Ky arsyetim i gjykatës, ka zhvendosur barrën e provës e cila në procesin penal i takon prokurorisë dhe jo të pandehurit apo personit nën hetim, i cili në procesin penal mbrohet nga parimi *in dubio pro reo*, ku çdo dyshim i akuzës çmohet në favor të tij.

Në rastin objekt gjykimi mungojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 228/3 të Kodit të Procedurës Penale si: nuk ka asnjë të dhënë serioze se qenia në detyrë e personit nën hetim Artan Shkëmbi vë në rrezik marrjen apo vërtetësinë e provës (neni 228/3/a); nuk ka asnjë të dhënë serioze se qenia në detyrë e personit nën hetim Artan Shkëmbi mund ta lidhë atë me kryerjen e krimeve më të rënda ose të të njëjtit lloj me atë me të cilin po procedohet (neni 228/3/c). Kjo referuar personalitetit të personit nën hetim dhe karrierës së tij në Policinë e Shtetit prej 20 vjetësh, në detyra të rëndësishme si: Drejtor i Drejtorisë Hetimore dhe Zv/Drejtor i OFL; në vitet 2010-2012 Oficer Ndërlidhës i Policisë së Shtetit në Ambasadën e Shqipërisë në Berlin; nuk ka pasur asnjëherë shkelje të ligjshmërisë dhe nuk është ndëshkuar me masë disiplinore, në të kundërtën është vlerësuar dhe shpërblyer për punën e kryer në veçanti në luftën kundër krimit të organizuar; në shumë operacione të suksesshme kombëtare dhe ndërkombëtare me bashkëpunim të shumë vendeve të BE dhe EUROPOL-it të drejtuar dhe menaxhuara nga personi nën hetim nuk ka pasur probleme dekonspirimi. Personi nën hetim mban Certifikatën e Sigurisë së nivelit “C” ,”Tepër Sekret”, ç’ka tregon për pastërtinë e figurës së tij.

## **II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë**

7. Rekursi, nga personi nën hetim Artan Shkëmbi është paraqitur brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale si dhe është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij. Rekursi i është njoftuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar pranë kësaj gjykatë.

8. Neni 432 i Kodit të Procedurës Penale, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

9. Duke ju kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të personit nën hetim për shkelje të ligjit procedural penal, neneve 228, 229, 240 dhe 242 të Kodit të Procedurës Penale të paraqitura si shkaqe edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Kolegji sjell në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit ekzsluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që referon në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

10. Në tërësi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë nga personi nën hetim Artan Shkëmbi, kundër vendimit me nr. 31, datë 15.10.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të sipërpërmendura dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet.

## **PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale,

## **V E N D O S I:**

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personi nën hetim Artan Shkëmbi, kundër vendimit me nr. 31, datë 15.10.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 18.12.2020